

Takimi i 1531-të , 10-12 Qershor 2025 (DNj)

H46-1 Durdaj dhe të tjerë dhe Nika k. Shqipërisë (kërkesat Nr. [63543/09](#) dhe [1049/17](#))

Monitorimi i ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane

Dokument reference
CM/Shënime/1531/H46-1

Vendimet

Të Deleguarit

1. rikujtuan se këto çështje kanë të bëjnë kryesisht me joefektivitetin e hetimeve në lidhje me një shpërthim në një objekt të çmilitarizimit të armëve që rezultoi në vdekje dhe plagosje të rënda (çështja Durdaj dhe të tjerë) ose përdorimin e pajustifikuar të armëve të zjarrit nga agjentët shtetërorë gjatë një proteste politike që rezultoi në vdekjen e të afërmit të aplikantëve, mangësitë në kuadrin ligjor mbi përdorimin e armëve të zjarrit dhe mangësitë në planifikimin dhe kontrollin e operacioneve policore (rasti Nika);

Lidhur me masat individuale

2. Lidhur me çështjen Durdaj dhe të tjerë, u bënë thirrje autoriteteve të marrin masat e nevojshme për parandalimin e vonësive të mëtejshme në gjyqin për shpërdorim detyrë ndaj ish-Ministrit të Mbrojtjes dhe të paraqesin informacion të përditësuar mbi ecurinë e gjyqit; duke vënë në dukje me interes përfshirjen e kërkuësve dhe të afërmeve të tyre në gjyq, ftuan autoritetet të paraqesin informacion të mëtejshëm mbi mënyrat se si sigurohet pjesëmarrja e tyre në lidhje me mbledhjen e provave dhe akimimin e vendimit;

3. Lidhur me rastin Nika, shënuan me interes rifillimin e hetimit penal dhe i inkurajuan fuqimisht autoritetet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që hetimi të kryhet me kujdes dhe tërësisht dhe të përfundojë në afatin e duhur;

Lidhur me masat e përgjithshme

4. shënuan me kënaqësi se kuadri i ri ligjor mbi përdorimin e armëve të zjarrit është plotësisht në përputhje me kërkesat e Nenit 2 të Konventës dhe përfshin masa të shumta mbrojtëse, pasi përdorimi i armëve të zjarrit lejohet vetëm në raste rreziku për jetën dhe i nënshtrohet një testi të domosdoshmërisë absolute dhe si mjet i fundit; dhe se ekziston një kuadër gjithëpërfshirës për planifikimin dhe kontrollin e operacioneve policore gjatë tubimeve, dhe se janë organizuar aktivitete të shumta trajnimi;

5. vërejtën me interes informacionin se tubimet janë zhvilluar në një atmosferë të qetë dhe se qysh prej vitit 2014 nuk kanë ndodhur incidente të ngjashme që përfshijnë përdorimin e armëve të zjarrit nga agjentët shtetërorë, duke treguar ndikimin pozitiv të masave të miratuara; megjithatë, ftuan autoritetet të paraqesin informacion mbi zbatimin e kuadrit të ri në situata të tjera ku përdorimi i armëve të zjarrit nga policia është i autorizuar;

6. vunë në dukje me interes se, pas reformave kushtetuese dhe ligjore, pavarësia e prokurorëve tashmë garantohej më mirë nga ndikimi politik; mirëpritën gjithashtu ndryshimet ligjore që synojnë forcimin e të drejtave të viktimave dhe personave që kanë bërë kallëzim penal në fazën paraprake të gjykimit, si dhe forcimin e shqyrtimit gjyqësor të vendimeve të prokurorisë për të pushuar një çështje, dhe ftuan autoritetet të paraqesin informacion në përgjigje të aspekteve të identifikuara në analizën e Sekretariatit;

7. ftuan autoritetet të paraqesin informacion mbi zbatimin e këtyre reformave dhe mbi mënyrën se si ato sigurojnë në praktikë përshtatshmërinë, shpejtësinë dhe kryerjen me kujdes të hetimeve, duke përfshirë përgjegjësinë penale të zyrtarëve të rangut të lartë për ngjarje që kanë rezultuar në humbje jete ose plagosje të rënda; i ftuan ata gjithashtu të japin informacion mbi praktikën hetimore dhe gjyqësore mbi rastet lidhur me aktivitete të rrezikshme ose përdorimin e armëve të zjarrit nga agjentët shtetërorë, si dhe mbi hetimet disiplinore në lidhje me ngjarje të tilla, si dhe të dhënat statistikore të disponueshme mbi fillimin dhe rezultatin e hetimeve të tilla;
8. ftuan autoritetet të japin vlerësimin e tyre se si garantohen të drejtat e viktimave dhe të të afërmve të tyre në fazën e gjykimit, në ligj dhe në praktikë, në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në mbledhjen e provave dhe të drejtën e tyre për ankim, si dhe nëse janë të nevojshme masa të mëtejshme ligjore ose të tjera në këtë drejtim;
9. ftuan autoritetet të paraqesin informacion mbi të gjitha çështjet e pazgjidhura të përmendura më sipër, si dhe mbi aspektet e identifikuara në analizën e Sekretariatit deri në fund të dhjetorit 2025 dhe vendosën të rifillojnë shqyrtimin e këtyre çështjeve në një nga takimet e tyre të DNJ në vitin 2026.